



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:282299

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06176964

C-III-13-0221

Paditësi:

E Th fshati M, Malishevë.
Përfaqësuar nga B Xh, avokate në Malishevë.

Kundër:

E paditura:

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- Prishtinë, Rr. "Driton Hoxha", nr. 55, Lakërishtë- Prishtinë.
OPB,, Mirusha,, në Malishevë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Ganimete Puka, gjyqtare kryesues gjyqtarëve Asllan Krasniqi dhe Agron Hoxhaj, anëtarë, në seancën dëgjimore publike, të mbajtur me 13.shtator.2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE**

- 1. Padia e paditësit hedhet poshtë.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 10.prill.2013, paditësi përmes avokates së tij, ka paraqit padi në DHPGJS, më të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë nga baza e trashëgimisë. Paditësi pretendon së, është pronar nga baza e trashëgimisë së ngastrës kadastrale nr., në sipërfaqe nr.01.85.65 ha, ZK-M. Një pjesë e kësaj ngastre pa bazë ligjore ju është marrë paraardhësit juridik të paditësit, të ndjerit S Th, dhe janë bartë si pronësi shoqërorë. I ka propozua gjykatës që t'ia pranoj një të drejt të tillë dhe të detyrohet e paditura, t'ia mundësoj kalimin e kësaj pjesë të palujshmeri/së në emër

të tij. Padiësi si provë ka dorëzuar aktvendimin e trashëgimisë T.nr., dt., tri certifikata të pronësisë, të dt.15.03.2013, si dhe autorizimin për përfaqësim.

Më 04.mars.2016, e paditura AKP, ka paraqit mbrojtje në padi dhe ka theksuar së padiësi e ka paraqitur padinë në kundërshtim me nenin 27.2 të shtojcës së ligjit nr.04/L-0033, për Dhomën e Posaçëm, dhe nenin 253 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, duke theksuar së pohimi i padiësit, së prona ju është marrë pa bazë ligjor është i pa qëndrueshëm, i pa argumentuar dhe i pa bazua në ligj. Padiësit nuk ka dorëzuar prova për të vërtetuar së nga cila bazë ligjor paraardhësi i tij e ka humbur pronën. Pohimi i padiësit, së e paditura nuk është duke i shfrytëzuar këto ngastra nuk i jep të drejt padiësit në fitimin e të drejtës së pronësisë, dhe së veprimet e padiësit janë në kundërshtim me ligjin sepse padiësi pa bazë ligjore e mbanë pronën e huaj, dhe së tani NSH OPB Mirusha, gjendët në procedurën e likuidimit. I ka propozua gjykatës që ta refuzoj padinë e padiësit si të pa bazuar.

Më 29.shkurt.2024, e autorizuar e padiësit ka pranuar urdhrin e gjykatës si dhe mbrojtën e AKP/së, më të cilinë urdhër ishte urdhëruar për të dhënë përgjigje në mbrojtën e AKP/së, si dhe të paguaj taksën gjyqësor për padi. E autorizuar e padiësit taksën gjyqësor e ka paguar, ndërsa nuk ka dhënë përgjigje ndaj mbrojtjes së të paditurës.

Më 13.shtator.2024, në ora 13:30, është mbajtur seancë dëgjimore në mungesë të autorizuarës së padiësit, e në prezencë të përfaqësuesit të të paditurës AKP/së.

Arsyetimi ligjor:

Padia e padiësit hedhet poshtë.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 58.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjësis mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

Më 13.shtator.2024, në ora 13:30, Kolegji gjykues ka mbajtur seancë dëgjimore në këtë çështje juridike. Në Gjykatë nuk është paraqit e autorizuar e padiësit edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt. Përfaqësuesi i të paditurës AKP, i ka propozuar gjykatës që në përputhje me neni 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Gjykata konstaton së e autorizuar e padiësi ishte ftuara në mënyrë të rregullt për seancën e dëgjimore. Ftesa për seancë ishte pranuar me 29.korrik.2024. Gjykata më urdhrin për caktimin

e seancës i ka njoftua palët së nëse dështojnë të paraqiten në seancën dëgjimore, gjykata përsëri mund ta gjykoj lëndën dhe të merr vendim mbi meritat apo të lëshoj Aktgjykim për mosparaqitje.

Gjykata nuk ka pranuar ndonjë njoftim nga e autorizuar e paditësi, me të cilin do të theksonte arsyet për mos prezencën e saj në seancë si dhe duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të paditurës AKP që të merret Aktgjykim për mosparaqitje, kolegji vlerëson se kushtet për nxjerrjen e një aktgjykimi të tillë janë plotësuar, ashtu siç janë të parapara në nenin 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje brenda një (1) muaji nga pranimi i të njëjtit. Kërkesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka, Gjyqtare kryesues

Asllan Krasniqi, Gjyqtar

Agron Hoxhaj, Gjyqtar
